



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 133/5 prot

Tiranë, më 07.02.2025

VENDIM

Nr. 01, datë 07.02.2025

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 2692 Prot., datë 27.12.2024, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bordi i Mbikëqyrjes Publike” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Z. \_\_\_\_\_ (në vijim “Ankuesi”), me anë të kërkesës datë 13.12.2024, depozituar në adresën elektronike [klea.rodhani@bmp.al](mailto:klea.rodhani@bmp.al), ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. Buxhetin total të harxhuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike për periudhën 2017 - 2023.
2. Listën e plotë të anëtarëve të Bordit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017-2023 si dhe për periudhën 1 janar 2024 - 13 dhjetor 2024.
3. Listën e plotë të anëtarëve të anëtarëve të Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale (KPAP) për periudhën 2017-2023 si dhe për periudhën 1 janar 2024 - 13 dhjetor 2024.
4. Listën e plotë të anëtarëve të Komisionit të Investigimit dhe Disiplinës (KIDB) në vitin 2017 si dhe për periudhën 1 janar 2024 - 13 dhjetor 2024.
5. Listën e plotë të anëtarëve të Komisionit Ligjor për vitin 2017-2023 si dhe për periudhën 1 janar 2024 - 13 dhjetor 2024.

Autoriteti Publik nëpërmjet *e-mail*-it të datës 26.12.2024, i ka kthyer përgjigje ankuesit në lidhje me pikën e parë dhe të dytë të kërkesës, duke refuzuar dhënien e informacionit në lidhje me pikën e tretë, të katërt dhe të pestë të kësaj kërkesë.

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, pasi nuk ka marrë përgjigje të plotë nga Autoriteti Publik, ankuesi, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, regjistruar me nr. 2692 Prot., datë 27.12.2024, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, me shkresën nr. 2692/2 Prot., datë 07.01.2025 ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar, duke vlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 13.01.2025.

Në vijim të shkresës së sipërcituar, Autoritetit Publik, me shkresën nr. 20 Prot., datë 13.01.2025, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 133 Prot., datë 15.01.2025, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “*Së pari, lidhur me pretendimin e palës ankuese se “BMP financohet nëpërmjet Buxhetit të Shtetit”, sqarojmë se pika 1 e nenit 4/1 e ligjit nr. 10091/2009 i ndryshuar, përcakton se: “Financimi i veprimtarisë së Bordit të Mbikëqyrjes Publike bëhet: a) nëpërmjet të ardhurave të mbledhura nga: i. pagesa prej 3 për qind, e caktuar mbi shumën e honorarit të faturuar për çdo auditim të njësive ekonomike me interes publik, të paguara nga shoqëritë audituese/audituesit ligjorë, që kryejnë auditime të njësive ekonomike me interes publik; ii. fonde të tjera, që vijnë nëpërmjet kontributit të organizatave të tjera profesionale, subjekt i mbikëqyrjes nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike; iii. shumat që u ngarkohen audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, subjekt të masave disiplinore, për të mbuluar shpenzimet e procedurave disiplinore, të cilat vendosen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike; iv. teprica të papërdorura nga proceset e provimit përfundimtar të kandidatëve për kontabilistë të miratuar dhe auditues ligjorë; v. fonde të tjera, nga burime të ligjshme, të pandikuara nga audituesit ligjorë, përfshirë, por pa u kufizuar në to, grantet e akorduara në kuadër të sigurimit të cilësisë dhe mbikëqyrjes së profesionit; b) nëpërmjet Buxhetit të Shtetit, sipas përcaktimeve në ligjin vjetor të buxhetit”. Sa më sipër, ligji vjetor i buxhetit të shtetit nuk ka parashikuar dhe nuk parashikon financim për veprimtarinë e BMP. Bordi është një*

autoritet rregullator i pavarur dhe që prej krijimit të tij, nuk ka marrë asnjë financim nga buxheti i shtetit dhe ushtron veprimtarinë e tij funksionale me vetëfinancim të plotë.

Sa më sipër, sqarojmë se, palës ankimuese i është vënë në dispozicion i gjithë informacioni i kërkuar duke zbatuar kufizimet e përcaktuara në pikën 6 të nenit 17 të ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit", i ndryshuar, si edhe ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, për përdorimin e të dhënave personale për qëllime të ndryshme nga qëllimi parësor i përpunimit të tyre. Konkretisht, në pikën 3 të nenit 27 "Masat për sigurinë e të dhënave personale", përcaktohet se: "Të dhënat e regjistruara nuk përdoren për qëllime të ndryshme, që nuk janë në përputhje me qëllimin e grumbullimit. Ndalohet njohja ose çdo përpunim i të dhënave të regjistruara në dosje për një qëllim të ndryshëm nga e drejta për të hedhur të dhëna. Përfshihet nga ky rregull rasti kur të dhënat përdoren për të garantuar sigurinë kombëtare, sigurinë publike, parandalimin dhe hetimin e kryerjes së një vepre penale, apo ndjekjen e autorëve të saj, ose për shkelje të etikës për profesionet e rregulluar." Sa më sipër, të dhënat e anëtarëve të komisioneve të ngritur pranë BMP dhe në kushtet kur një pjesë e tyre nuk janë më anëtarë, mund të përdoren vetëm për qëllime ligjore të cilat kanë lidhje me objektin e aktivitetit të Bordit dhe detyrën funksionale të anëtarit të komisionit. Për rrjedhojë, dhënia e këtij informacioni është e kufizuar nga dispozitat e sipërcituara. Gjithashtu, neni 28 "Konfidencialiteti i të dhënave" i ligjit të sipërcituar, përcakton se: "Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj". Në frymën e parashikimeve të mësipërme shprehet edhe Kodi i Punës, ku në nenin 33 pika 3 e tij, përcaktohet se: "Punëdhënësi, që vihet në dijeni me të dhënat e përpunuara të punëmarrësit, gjatë ushtrimit të detyrës së tij, detyrohet të ruajë konfidencialitetin dhe besueshmërinë. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit është i pakufizuar në kohë". Për sa më sipër, palës ankimuese i është vënë në dispozicion gjithë informacioni i kërkuar duke respektuar të drejtën e informimit dhe interesin publik për dhënie informacionit, si dhe duke mbajtur në konsideratë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale."

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi, me e-mail-in datë 21.01.2025, protokolluar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 133/1 Prot., datë 17.01.2025, ka vijuar ankimin duke pretenduar se: "...Në lidhje me ankesën ndaj Bordit të Mbikëqyrjes Publike, ju kërkohet të merren masa administrative ndaj këtij institucioni publik ose një seancë dëgjimore sepse pavarësisht të gjitha justifikimeve të pabazuara në ligj, ky Bord është një Autoritet Publik dhe si i tillë i nënshtrohet ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" i ndryshuar, ku përfshihet dhënia e informacionit publik."

Për këtë, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, si dhe evidentimin e personave përgjegjës të caktuar për trajtimin e kërkesës për informacion, me Urdhrin nr. 22, datë 22.01.2025, Komisioneri vendosi fillimin e shqyrtimit administrativ pranë Autoritetit Publik duke filluar

nga data 28.01.2025. Pranë Autoritetit Publik u depozitua urdhri i inspektimit administrativ, protokolluar me nr. prot. 10, datë 24.01.2025 nga BMP.

Për sa më sipër, grupi i inspektimit kontaktoi me përfaqësuesen e Autoritetit Publik së cilës i është kaluar për trajtim kërkesa për informacion, znj. Erjola Vejzati, Drejtor Ekzekutiv, ku iu kërkua informacion nëse dokumentacioni i kërkuar disponohet nga Autoriteti Publik, si dhe për të administruar qëndrimin përfundimtar në lidhje me çështjen objekt inspektimi.

Përfaqësuesja e Autoritetit Publik sqaroi se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar, disponohet nga ky i fundit, si dhe rikonfirmoi qëndrimin si më sipër trajtuar, duke refuzuar vendosjen në dispozicion të tij.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri konstaton se, Autoriteti Publik, ka përmbushur detyrimin duke vendosur në dispozicion informacionin lidhur me pikën 1 dhe pikën 2, për të cilën nga ana e ankuesit nuk është depozituar ankim. Ndërkohë, për sa i përket pikës 3, 4 dhe 5, të kërkesës për informacion, për të cilat ankuesi ka depozituar ankim, Autoriteti Publik ka informuar se, informacioni i kërkuar nga ankuesi nuk përfshihet në kategorinë e “informacionit publik”, referuar përkufizimit të dhënë në LDI.

Gjithashtu, Autoriteti Publik argumenton se, informacioni lidhur me anëtarët e komisioneve të ngritura pranë BMP, konkretisht Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale (KPAP), Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës (KIDB), Komisioni Ligjor, për periudhën 2017 - 2024, konsiderohet si informacion i brendshëm. Ndërkohë, krahas kufizimeve ligjore të cituara, Autoriteti Publik ka vendosur në dispozicion anëtarët e KPAP, emrat e së cilëve janë të publikuar në faqen zyrtare të BMP, por nuk ka vendosur në dispozicion emrat e anëtarëve të tjerë të këtij komisioni (periudha 2017-2020) si dhe të komisioneve të tjera, duke mos përmbushur në këtë mënyrë kërkesat për informacion mbi të cilat është depozituar ankesa.

Komisioneri vlerëson se, ky qëndrim i mbajtur nga Autoriteti Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI dhe ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e te Dhënave Personale”, i ndryshuar, i zbatueshëm në kohën e depozitimit të kërkesës për informacion.

Konkretisht, bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.*

Në kuptim të këtij parashikimi, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike”.* Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë

e “*prodhuesit*” apo “*mbajtësit*” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.

Autoriteti Publik pretendon se: “... të dhënat e anëtarëve të komisioneve të ngritur pranë BMP dhe në kushtet kur një pjesë e tyre nuk janë më anëtarë, mund të përdoren vetëm për qëllime ligjore të cilat kanë lidhje me objektin e aktivitetit të Bordit dhe detyrën funksionale të anëtarit të komisionit. Për rrjedhojë, dhënia e këtij informacioni është e kufizuar nga dispozitat e sipërcituara. Gjithashtu, neni 28 “Konfidencialiteti i të dhënave” i ligjit të sipërcituar, përcakton se: “Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj”.

Në lidhje me këtë pretendim, Komisioneri vlerëson se, në këtë rast gjen zbatim shkronja b) e pikës 4 te neni 4 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre”. Ky parashikim aplikohet sipas legjislacionit në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë të të dhënave. Në këtë kuptim, përhapja e informacionit duhet të kufizohet vetëm me aksesimin e dokumenteve të dosjes personale të subjektit të të dhënave (të dhëna të dosjes personale të funksionarit publik) që përmbajnë të dhëna personale të lidhura ngushtësisht me individin dhe si të tilla, nuk mund të vendosen në dispozicion të askujt pa pëlqimin paraprak të tij.

Ndërkohë, nga verifikimi i kërkesës për informacion rezulton se ajo konsiston vetëm në marrjen e informacionit mbi emrat e anëtarëve të Komisioneve të sipërcituara dhe jo në aksesimin e dokumentacionit që përmban të dhëna personale apo të mendimeve të shprehura nga këto anëtarë, për të cilat edhe mund të qëndrojnë argumentat e paraqitura nga Autoriteti Publik.

Në këtë këndvështrim, Komisioneri vlerëson se, në këtë rast e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale ushtrohet në përputhje me të drejtën e aksesit të publikut në dokumente zyrtare të mbajtura nga një autoritet publik, si dhe në përputhje me të drejtën për informim dhe aksesin e publikut në informacionin, që lidhet me një person nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje që lidhen me kryerjen e funksioneve dhe detyrave zyrtare të tij, me përjashtim të rasteve specifike ose kategorive të rasteve specifike kur për mbrojtjen e të drejtave të tjera themelore të tij nevojitet mbrojtja e të dhënave personale.

Përforcuar kjo edhe në ligjin e ri nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, ku pika 2 e neni 44 parashikon se: “... Aksesin e publikut në informacionin publik, siç përcaktohet në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, dhe aksesin e publikut në informacionin që lidhet me kryerjen e funksioneve dhe të detyrave zyrtare, nuk pengohet nga e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale të personave fizikë, të cilët konsiderohen si autoritete publike ose ushtrojnë funksione shtetërore, përveç rasteve kur të drejta të tjera



*themelore, si e drejta e tyre për jetën ose e drejta e tyre për integritet fizik e mendor kërkojnë mbrojtjen e të dhënave të tyre në një rast ose kategori të caktuar rastesh...*

Ndërkohë, përkufizimi i termit “Zyrtar” zërthehet specifikisht në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, sipas të cilit “Zyrtar” është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike. Gjithashtu sipas parashikimit të nenit 4 të po këtij ligji, brenda sferës së këtij përkufizimi përfshihet çdo zyrtar që merr pjesë në një vendimmarrje.

Nga analizimi i legjislacionit të brendshëm të funksionimit të Autoritetit Publik, rezulton se nuk ka pengesa ligjore lidhur me dhënien e informacionit objekt shqyrtimi, përkundrazi kjo procedurë nga këto akte ligjore parashikohet të jetë transparente. Konkretisht, në nenin 3, pika 7 e Rregullores nr. 2 datë 22.02.2018 “Për funksionimin e Komisionit të Provimeve të Aftësive Profesionale dhe Mbikëqyrjes së Procesit të Testimit të Kandidatëve për Auditues Ligjor dhe Kontabilist të Miratuar të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, e ndryshuar, parashikohet se: “7. Kandidatët për anëtarë që i propozohen BMP-së nga institucionet, duhet të përzgjidhen prej tyre në një proces të hapur, transparent, gjithëpërfshirës, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Dokumentacioni i përzgjedhjes ruhet pranë organizatës profesionale për të paktën tre vite, dhe është subjekt i mbikëqyrjes së BMP-së.”

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur Autoriteti Publik pranon zotërimin e informacionit, ai rrjedhimisht përmbush kriteret e pikës 2, të nenit 2 të LDI, në të cilën parashikohet se: “Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”. Në kuptim të kësaj dispozite, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit/ankuesit informacionin në formatin e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Në këto kushte, pas shqyrtimit në tërësi të provave dhe sa i përket përgjegjësisë për refuzimin e dhënies së informacionit, nga verifikimi i dokumentacionit administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, si dhe deklarimit gjatë inspektimit të kryer, Komisioneri konstaton se znj. Erjola Vejzati, me detyrë Drejtor Ekzekutiv i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, është personi përgjegjës, i cili nuk ka përmbushur detyrimin për kthimin e përgjigjes së kërkesës për informacion, rrjedhimisht ka refuzuar dhënien e informacionit.

Znj. Erjola Vejzati, gjatë inspektimit, iu komunikua se kërkesa është trajtuar brenda afatit të përcaktuar në LDI, duke refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar me argumentin si më sipër trajtuar. Lidhur me këtë konstatim, nga ana e nëpunësit nuk u paraqit asnjë pretendim, vërtetuar kjo nga procesverbali i mbajtur pranë Autoritetit Publik, në të cilin citohet se: “...Përfaqësuesit e Autoritetit Publik parashtruan se janë dakord me inspektimin e kryer dhe të gjitha referencat e përmendura më sipër. Procesverbali pasi u lexua nga të pranishmit dhe pasi u gjet i shkruar drejtë, nënshkruhet rregullisht”.

Për sa më sipër, bazuar në LDI neni 18, pika 2, shkronja ‘a’, ku citohet se: “Veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale,

*konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë: a) refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 300 000 lekë”;...”.*

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, jemi përpara parashikimit të pikës 2 të nenit 18 më sipër cituar dhe personit përgjegjës për refuzimin e vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar, znj. Erjola Vejzati duhet sanksionuar me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë. Masa e gjobës caktohet duke marrë parasysh shkeljen e përsëritur të Autoritetit Publik për refuzimin e dhënies së informacionit në praktikën e mëparshme të trajtura nga Zyra e Komisionerit, në përputhje kjo me ligjin Nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative, konkretisht neni 18 “Kriteret për caktimin e llojit dhe të masës së dënimit”, i cili citon se: “Në përzgjedhjen e llojit të dënimit dhe në caktimin e masës së tij, në rastet kur ligji ka parashikuar kufij minimalë e maksimalë të vlerës së gjobës, organi që shqyrton kundërvajtjen administrative duhet të marrë parasysh: a) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes; b) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë; c) rëndësinë e kundërvajtjes; ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.”.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Gjithashtu, ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen “Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias, ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikëqyrësit shoqëror”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në shkronjën c), të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 2692 Prot., datë 27.12.2024 nga z. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik, “Bordi i Mbikëqyrjes Financiare”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar për pikat 3, 4 dhe 5 të kërkesës për informacion datë 13.12.2024. duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI, brenda datës 14.02.2025.
3. Dënimin e znj. Erjola Vejzati, me detyrë Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit Publik, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore bazuar në pikën 1 dhe 2 të nenit 21 të ligjit të sipërcituar. Gjoha ekzekutohet nga Struktura e Financës së Autoritetit Publik brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit në përputhje me nenin 23 të ligjit të sipërcituar.
4. Kundër vendimmarrjes në pikat 1 dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
5. Kundër vendimmarrjes në pikat 3, personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ, ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
6. Ky vendim u shpall sot në datë 07.02.2025.

## KOMISIONERI

**Besnik Dervishi**